



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr/Br.

Datë/Datum.

814/19

26.12.2019

PRISHTINË - PRISTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.814 /19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Goran Milenkovic - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “PROFESSIONAL ALARM L.L.C”-Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore në arkivin Komunal të Prishtinës” me nr. të prokurimit: 616-19-6729-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prishtinë, më datën: 16.12.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “PROFESSIONAL ALARM L.L.C”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore në arkivin Komunal të Prishtinës” me nr. të prokurimit: 616-19-6729-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ –Komuna Prishtinë.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës, ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosje e tenderit, në pajtim me nenin 53.7 të LPP-së, dhe ti merre parasysh rekomandimet e ekspertit shqyrtues/teknik, lidhur me aktivitetin të prokurimit “Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore në arkivin Komunal të Prishtinës” me nr. të prokurimit: 616-19-6729-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ –Komuna Prishtinë.

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “PROFESSIONAL ALARM L.L.C”-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “PROFESSIONAL ALARM L.L.C”-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.11.2019, me nr. 814/ 19, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore në arkivin Komunal të Prishtinës” me nr. të prokurimit: 616-19-6729-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ –Komuna Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 28 dhe 65 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.10.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 10.12.2019 sqaron si në vijim,
Përgjigje në Pretendimin - 1

OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje të Nenit 7 dhe 28 të LPP-së duke vendosur kërkesa dhe specifikime teknike që favorizojnë një prodhues të caktuar; në këtë rast prodhuesi FirePro.

Në dokumentin ku janë dhënë përshkrimi teknik për sistemin kundër zjarrit, janë dhënë informata konkrete se sistemi dhe pajisjet që kërkohen përmes këtij aktiviteti janë të prodhuesit FirePro. Konkretisht në dokumentin për përshkrimin teknik, në 8 pozicione përshkruhet emri i prodhuesit FirePro. Duke qenë kështu, elementet dhe specifikimi teknik i tyre janë identik me ato të prodhuesit FirePro. Për më shumë në këtë dokument, tek pjesa Certifikatat/Aprovimet/Përvoja, janë përshkruar certifikatat, aprovimet dhe përvoja që kërkohet, e që korrespondon me prodhuesin FirePro. Sipas konstatimit të mësipërm, forma e tillë e kërkesave dhe specifikimeve në dosjen e tenderit dhe dokumentet përcjellëse është në kundërshtim me Nenin 28 të LPP-së, ku kërkohet që AK të përpilojë specifikime teknike në atë mënyrë që ato të jenë të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Dhe se është veçanërisht e ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik duke ju referuar një artikulli ose burimi të veçantë. Forma e tillë e vendosjes së kërkesave dhe specifikimeve teknike është në kundërshtim me Nenin 7 të LPP-së ku theksohet se AK do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, dhe se gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, AK do të sigurojnë pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomi.

Marrë për bazë sqarimet e mësipërme, pretendimi ankimor është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi – 2

Pretendim tjetër i OE ankues është se AK ka angazhuar një OE i cili ka marrë pjesë në hartimin e specifikimeve teknike për këtë aktivitet të prokurimit dhe i njëjti është distributor ekskluziv i prodhuesit për të cilin janë përshtatur specifikimet teknike të specifikuara në dosjen e tenderit të publikuar nga AK. Të njëjtin pretendim ankimor të OE ankues e ka paraqitur në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar pranë AK me datë 06.11.2019. Në vendimin e AK-së të datës 08.11.2019, përmes të cilit refuzohet kërkesa për rishqyrtim, AK përmes përgjigjes së dhënë AK ka konfirmuar se bëhet fjalë për OE të përmendur në pretendimin ankimor. Për më shumë AK e thekson se projektues i këtij aktiviteti është i certifikuar nga prodhuesi FirePro, produktet e të cilave janë përshkruar në dokumentet përcjellëse të dosjes së tenderit.

Andaj, duke marrë për bazë që aktiviteti është në fazën para hapjes së ofertave, AK gjatë procesit të Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahimit të Tenderëve duhet ta ketë parasysh Nenin 65 të LPP-së, paragrafi 1, ku thuhet “*Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj: 1.1.ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; ose 1.2. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje*

nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të ndonjë pjesë të këtyre të fundit.

Bazuar në sqarimet e mësipërme dhe në mbështetje të Nenit 114, paragrafit 2, rekomandohet që AK të ndërmarr veprime korrigjuese me qëllim që specifikimet teknike dhe kërkesat për të gjitha pjesët në këtë aktivitet, të jenë konform Nenit 28 të LPP-së, drejt qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit në këtë aktivitet të prokurimit.

Mendimi i ekspertit profesional:

Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE - "Professional Alram" L.L.C, të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të obligohet AK të bëjë korrigjimet sipas sqarimeve dhe të bëhet zgjatja e afatit për dorëzimin e ofertave konform dispozitave të LPP-së.

Operatori ekonomik me datën 10.12.2019 përmes shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e eksperti, mirëpo i njëjti nuk ka kthyer përgjigje.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 16.12.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 16.12.2019, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: Autorizimi i inicimi të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "PROFESSIONAL ALARM L.L.C"-Prishtinë, se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të Nenit 7 dhe 28 të LPP-së duke vendosur kërkesa dhe specifikime teknike që favorizojnë një prodhues të caktuar; në këtë rast prodhuesi FirePro. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se në dokumentin ku janë dhënë përshkrimi teknik për sistemin kundër zjarrit, janë dhënë informata konkrete se sistemi dhe pajisjet që kërkohen përmes këtij aktiviteti janë të prodhuesit FirePro. Konkretisht në dokumentin për përshkrimin teknik, në 8 pozicione përshkruhet emri i

prodhuesit FirePro. Duke qenë kështu, elementet dhe specifikimi teknik i tyre janë identik me ato të prodhuesit FirePro. Për më shumë në këtë dokument, tek pjesa Certifikatat/Aprovimet/Përvoja, janë përshkruar certifikatat, aprovimet dhe përvoja që kërkohet, e që korresponдон me prodhuesin FirePro. Andaj sipas sqarimeve të mësipërm, forma e tillë e kërkesave dhe specifikimeve në dosjen e tenderit dhe dokumentet përcjellëse është në kundërshtim me Nenin 28 të LPP-së, ku kërkohet që AK të përpilojë specifikime teknike në atë mënyrë që ato të jenë të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Dhe se është veçanërisht e ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik duke ju referuar një artikulli ose burimi të veçantë. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se forma e tillë e vendosjes së kërkesave dhe specifikimeve teknike është në kundërshtim me Nenin 7 të LPP-së ku theksohet se AK do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, dhe se gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, AK do të sigurojnë pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomi. Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "PROFESSIONAL ALARM L.L.C"-Prishtinë, se autoriteti kontraktues ka angazhuar një OE i cili ka marrë pjesë në hartimin e specifikimeve teknike për këtë aktivitet të prokurimit dhe i njëjti është distributor ekskluziv i prodhuesit për të cilin janë përshtatur specifikimet teknike të specifikuara në dosjen e tenderit të publikuar nga AK. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se të njëjtin pretendim ankimor të OE ankues e ka paraqitur edhe në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar pranë AK me datë 06.11.2019. Në vendimin e AK-së të datës 08.11.2019, përmes të cilit refuzohet kërkesa për rishqyrtim, AK përmes përgjigjes së dhënë AK ka konfirmuar se bëhet fjalë për OE të përmendur në pretendimin ankimor. Për më shumë AK e thekson se projektues i këtij aktiviteti është i certifikuar nga prodhuesi FirePro, produktet e të cilave janë përshkruar në dokumentet përcjellëse të dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se duke marrë për bazë që aktiviteti është në fazën para hapjes së ofertave, AK gjatë procesit të Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahimit të Tenderëve duhet ta ketë parasysh Nenin 65 të LPP-së, paragrafi 1, ku thuhet "*Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj: 1.1. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; ose 1.2. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e*

tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të ndonjë pjese të këtyre të fundit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik rekomandon autoritetin kontraktues të ndërmarr veprime korrigjuese me qëllim që specifikimet teknike dhe kërkesat për të gjitha pjesët në këtë aktivitet, të jenë konform Nenit 28 të LPP-së, drejt qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh sqarimet e dhëna si më lart nga eksperti shqyrtues/teknik konstaton se autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës në dosjen e tenderit ka vendosur kërkesa/ specifikacionet teknike në kundërshtim me nenin 7 dhe 28 të LPP-së, ku këto nene kanë përcaktuar se autoriteti kontraktues duhet të përpiloj specifika teknike të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa ma të mire për të gjithë operatorët ekonomik te interesuar me qëllim për të ndaluar autoritetin kontraktues qe të hartojnë specifika teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose me shumë operator ekonomik, andaj autoriteti kontraktues është i obliguar qe ti përmirësoj kërkesat/specifikacionet teknike konform dispozitave të cekura si më lart, duke vepruar ne pajtim me sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues/teknik konform nenit 57.3 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Prishtinë

1x1 OE-"PROFESSIONAL ALARM L.L.C"-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.